



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
Njësia Përgjegjëse e Sinjalizimit

Nr. ____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ . 2020

Lënda: Dërgim i raportit vjetor të punës për vitin 2019

KRYETARËS BASHKISË

Shkodër

INSPEKTORIATIT LARTË DEKLARIMIT KONTROLLIT
PASURIVE DHE KONFLIKTIT INTERESAVE

Tiranë

I.Përmbledhje ekzekutive

Njësia Përgjegjëse e Sinjalizimit- Bashkia Shkodër , gjatë vitit 2019, ka bashkëpunuar me strukturat e Bashkisë Shkodër, kryesisht sqarimin e ligjit të Sinjalizimit, kryesisht për veprat objekt i këtij ligji dhe mbrojtjen ligjore të garantuar nga ky ligj për administratën publike. Gjithashtu është punuar dhe në sensibilizimin dhe nxjitjen e punonjësve për të denoncuar rastet e veprimeve apo mos veprimeve të punonjësve të bashkisë të cilat kanë kryer veprime të kundraligjeshme.

Baza Ligjore.

Njësia Përgjegjëse e Sinjalizimit- Bashkia Shkodër është bazuar në ligjin 60/2016 “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve”; ligjin nr. 44/20151 “Kodi i Procedurave

Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Vendimin nr. 816 datë 16.11.2016 “Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të njësisë përgjegjëse në autoritetet publike, në zbatim të ligjit nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

II. Organizimi

II.1 Misioni i Njësisë Përgjegjëse Sinjalizimit

Njësia Përgjegjëse e Sinjalizimit- Bashkia Shkodër, për vitin 2019, ka patur si mision kryesor të saj parandalimi dhe goditja e korrupsionit në Bashkinë Shkodër, mbrojtjen e individëve që sinjalizojnë veprimet ose praktikave të dyshuara të korrupsionit në vendin e tyre të punës si dhe nxitjen e sinjalizimit të veprimeve ose praktikave të dyshuara të korrupsionit.

II.2 Organizimi i Njësisë Përgjegjëse të Sinjalizimit- Bashkia Shkodër

Njësia Përgjegjëse e Sinjalizimit- Bashkia Shkodër, është e organizuar referuar VKM nr. 816, datë 16.11.2016 “Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të njësisë përgjegjëse në autoritetet publike, në zbatim të ligjit nr. 60/2016, “për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, Urdhërit Nr. 840 datë 30.11.2016 të Kryetares Bashkisë Shkodër “Për ngritjen e Njësia Përgjegjëse e Përhershme për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

Njësia Përgjegjëse e Sinjalizimit- Bashkia Shkodër, Drejtohet nga Drejtuesi i Njësisë Auditimit dhe ndihmohet nga një audite me profesion Juriste.

III. Rezultatet e veprimtarisë së Njësisë Përgjegjëse Sinjalizimit

Njësia Përgjegjëse e Sinjalizimit, Gjate vitit 2019, ka kryer aktivitetin e saj kryesisht në sensibilizimin e administratës Bashkisë për të denoncuar rastet e konstatuara të veprimeve që janë objekt i ligjit 60/2016 “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve”, gjithashtu u është bërë e ditur dhe për detyrimet që ka administrata e Bashkisë Shkodër për rastet kur marrin dijeni për veprime korruptive dhe nuk bëjnë denoncimin.

Për vitin 2019, pranë Njësisë Përgjegjëse të Sinjalizimit- Bashkia Shkodër, nga administrata e Bashkisë Shkodër nuk janë paraqitur raste të denoncimit.

IV. Prioritetet për vitin 2020

Njësia Përgjegjëse e Sinjalizimit, Bashkia Shkodër për vitin 2020, si prioritet kryesor të saj do të ketë bashkepunimin me të gjithë administratën e Bashkisë për të bërë të mundur që nëpunësit të cilët me veprimet apo mos veprimet e tyre çenojnë interesat e Bashkisë Shkodër nuk zbatojnë ligjin apo e zbatojnë në interes të tyre, t’i nënshtrohen ligjit sinjalizimit apo ligjeve të tjera që rregullojnë veprimet korruptive.

Njësia Përgjegjëse e Sinjalizimit, Bashkia Shkodër për vitin 2020, do të insistojë në rritjen e nivelit profesional, nëpërmjet kualifikimeve të mëtejshme, kryesisht në procedurat administrative.

Përgjegjësi

PËLLUMB ZOGU